

HARUN JAHJA



Bota e Mique Tanë të Vegjël

MILINGONAT



DY FJALË RRETH AUTORIT



I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuar në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje

më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.


Të dashur fëmijë! Ju mund të mos keni dëgjuar asnjëherë më parë se, sa punëtore dhe inteligjente janë milingonat. Dikush nga ju mund të mendojë se, ato janë krijesa që ecin gjithë ditën duke mos bërë asgjë. Përkundrazi, ato janë krijesa plot me cilësi mahnitëse. Omeri, personazhi i këtij libri, ka rastin të mësojë për jetën e tyre nga një shoqe e tij. Ai ka mbetur pa mend nga ato që dëgjon nga ajo. Po çfarë e bën atë kaq të emocionuar? Ç'është më e rëndësishmja, kush është "kjo shoqe e vogël", e cila i mëson kaq shumë gjëra Omerit? Ju po vrisni mendjen se për çfarë bën fjalë ky libër. Pra, lexoni dhe zbulojeni...



Shtëpia Botuese "Furkan ISM"
Brigada II Maqedonase,
lokali 22 1000 Shkup, Maqedoni

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



BOBA E
MILINGONAVE,
MIQUE JANE
JE VEGJEL



Dy fjalë rreth autorit dhe veprave të tij

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimeve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenën dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuar në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizojnë librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

Të dashur fëmijë

o Në këtë libër i është kushtuar një kapitull i veçantë rrënies së teorisë së evolucionit, sepse kjo teori është baza e të gjitha filozofive materialiste. Darwinizmi mohon krejtësisht faktet e krijimit dhe ekzistencën e Allahut dhe, si rrjedhim, përgjatë 140 viteve të fundit shumë njerëz kanë braktisur besimin e tyre duke rënë pre e dyshimit. Për këtë arsye, është një detyrë e rëndësishme që t'i tregoni çdo njeriu se kjo teori s'është gjë tjetër veçse mashtrim. Meqenëse, jo të gjithë lexuesit mund të lexojnë disa nga librat tanë, ne e kemi menduar të arsyeshme që t'i kushtojmë një kapitull të veçantë të përmbledhur mbi këtë çështje.

o Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre të efektshme dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

o Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfituar nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

o Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

o Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

o Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjanuar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumenta të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe devijime në zemrat e tyre.

HARUN JAHJA

**BOTA E
MILINGONAVE,
MIQVE TANË
TË VEGJËL**



**Shtëpia Botuese "Furkan ISM"
Brigada II Maqedonase, lokali 22
1000 Shkup, Maqedoni**



MIRËSEVINI NË BOTËN E MILINGONAVE!

Gjatë rrugës për në shkollë, Omeri ecën pranë kopshtit të një shtëpie matanë rrugës dhe qëndron aty pakëz.

Në këtë kopsht jeton një mikeshë i tij e veçantë. Askush nuk e njih këtë mikeshë, por Omeri e do shumë.

Ai asnjëherë nuk harron ta vizitojë dhe kënaqet shumë me shoqërinë e saj. Mbi të gjitha, ai ka një mikeshë, e cila është më inteligjente se gjithë të tjerët.

Edhe pse shumë e vogël, shoqja e tij mund të bëjë shumë gjëra të rëndësishme. Ajo, madje, është punëtore e madhe.

Ajo i kryen të gjitha punët e saj shumë mirë dhe në kohë të caktuar, sikur të ishte ushtar në ndonjë ushtri. Edhe pse nuk shkon në shkollë si Omeri, ajo kryen me shumë sukses shumë detyra që duhet t'i kryejë në jetën e saj.

Ju, me siguri, pyesni veten se, kush është kjo mikeshë e vogël, apo jo?



Ajo është një milingonë e vogël, e cila mund të bëjë shumë gjëra të mrekullueshme.



Ndoshta, ju kurrë nuk keni dëgjuar se, sa të shkathëta dhe inteligjente janë milingonat e vogla. Disa prej jush, madje, mund t'i keni parë si insekte të thjeshta që bredhin gjithë ditën, pa bërë asgjë. Por, ata që mendojnë kështu, kanë gabuar shumë, sepse milingonat, si edhe shumë gjallesa të tjera, gjithashtu kanë një jetë të tyren. Omeri ka rastin t'i mësojë të fshehtat e kësaj jete nga mikesha e tij. Kjo është edhe njëra prej arsyeve pse Omerit nuk i shpëton asnjë vizitë dhe kënaqet shumë gjatë bisedave me të. Ai habitet shumë nga ato që mëson nga mikesha e tij për botën e milingonave dhe dëshiron t'u tregojë të tjerëve gjithçka që mëson rreth talentit, inteligjencës dhe veçorive të tjera të shkëlqyera të mikeshës së vet. Çka, atëherë, e bën Omerin kaq të emocionuar? Pse ai është aq i mrekulluar nga bota e milingonave? Edhe juve ndoshta jeni kuriozë të dini PSE. Pra, vetëm vazhdoni lexoni...



Milingonat kanë më shumë anëtarë se çdo gjallesë tjetër në botë. Për çdo 700 milionë milingona të ardhura në këtë botë, ka vetëm 40 foshnje prej njerëzve. Me fjalë të tjera, numri i milingonave në botë është shumë më i madh se i njerëzve. Familjet e milingonave janë, gjithashtu, shumë të mëdha. Për shembull, ju ndoshta keni një familje me 4-5 anëtarë, megjithatë, në familjen e milingonave, ndonjëherë, ka me miliona milingona. Tani mendo vetëm një minutë: sikur ti të kishe me miliona vëllezër dhe motra, a do të ishit në gjendje të jetoni në një shtëpi të vetme? Sigurisht që jo!

Tiparet mahnitëse të milingonave nuk mbarojnë këtu.


Megjithëse me miliona prej tyre jetojnë bashkë, ato nuk kanë probleme me njëra-tjetrën, nuk kanë rrëmujë dhe parregullsi. Ato bëjnë një jetë të planifikuar mjaft mirë ku, çdonjëra i bindet rregullave.

Disa familje milingonash merren me rrobaqepësi, të tjerat kultivojnë ushqimin e vet sikur bujqit, kurse, ca të tjera mbajnë ferma të vogla ku rrisin disa kafshë më të vogla. Ashtu si njerëzit mbajnë lopë dhe ua marrin qumështin, ashtu edhe milingonat mbajnë bimë (afide) dhe përdorin "qumështin" e tyre.

Tani, të shohim se ç'ka për të thënë Omeri rreth botës së milingonave.

Milingonat endëse janë rrobaqepëse të shkathëta. Ato i ndërthurin gjethet duke i tërhequr nga të dy anët dhe duke qepur gjethet së bashku. Në këtë mënyrë, ato ndërtojnë një shtëpi të mrekullueshme për vete.





Milingonat rojtare ruajnë fole të. Ato e bëjnë këtë punë me shumë sukses. Edhe milingonat e tjera janë, po ashtu, punëtore të zellshme. Ato i kryejnë të gjitha punët e folesë.



OMERI: Në fillim e pashë kokën e saj të vogël duke dalë nga toka. Ajo ma tërhoqi vëmendjen, pasi, ishte paksa më e madhe se trupi i saj. Pyesja veten, pse koka e saj ishte ashtu dhe fillova ta vërej me kujdes këtë mikeshë të vogël. Koka e madhe, në trupin e saj të vogël, e ndihmonte që të shërbente si roje në hyrje të folesë. A doni ta dini "si"? Ajo kontrollonte milingonat që donin të hynin, nëse ishin nga familja e saj apo jo, dhe nuk i linte brenda nëse ato ishin të huaja. Menjëherë, pasi e pashë, i fola dhe e luta të më tregojë çka po ndodhte brenda. Mikesha ime e vogël e kuptoi kërshtërinë time dhe filloi të më shpjegonte. Unë doja të dija se, si milingonat me kokë të madhe i njohin banorët e folesë së tyre dhe i lënë ata brenda.

MILINGONA: Omer, më lerë të të tregoj se, ne familjet tona i quajmë "koloni". Me fjalë të tjera, ne jetojmë në bashkësi të quajtura koloni. Një milingonë shumë lehtë e di nëse milingona tjetër i takon kolonisë së saj apo jo. Këtë e bën duke prekur trupin e milingonës tjetër me antenat e veta, (shkopthat e vegjël në majë të kokës) të cilat e ndihmojnë ta dallojë të huajin, falë "aromës karakteristike të kolonisë". Nëse milingona është e huaj, nuk mund ta lejojmë të hyjë në shtëpinë tonë. Ndonjëherë përdorim edhe forcën për ta përzënë që atje.



**Milingonat duke "biseduar"
me njëra-tjetrën me anë të
prekjes.**

**Milingonat nuk duan që
të huajt të hyjnë në
folenë e tyre, sepse kjo
do ta kërcënonte
sigurinë e tyre. Ato nuk
ngurrojnë të futen në
luftë për të mbrojtur
folenë dhe shoqet e
tyre.**





Omeri u befasua kur dëgjoi për sistemin e tyre të përsosur të sigurisë dhe pyeste veten se, si guxonin të huajt të provonin të hynin në fole. Kur ia tha këtë mikeshës të tij, ajo buzëqeshi me të dhe tha që kishte edhe shumë gjëra të tjera që do ta mrekullonin atë.

Më pas, milingona i tha: "Do të të tregoj për brendësinë e folesë, për të cilën je kurioz të dish. Kolonitë tona përbëhen nga mbretëresha, milingonat meshkuj, ushtarët dhe milingonat punëtore.




**Milingonat kanë
detyra të
ndryshme. Ato
punojnë
shumë, pa
pushuar aspak.**



Mbretëresha dhe meshkujt kujdesen për shumimin e llojit tonë. Mbretëresha është me e madhe se të gjithë ne. Detyra e meshkujve është që ta bëjnë mbretëreshën të lindë milingona të reja. Ushtarët janë përgjegjës për mbrojtjen e kolonisë, për gjetjen e ushqimit dhe vendeve të reja për fole. Grupi i fundit përbëhet nga milingonat punëtore. Të gjitha milingonat punëtore janë milingona femra sterile.





Kjo do të thotë se ato nuk mund të lindin.

Ato kujdesen për mbretëreshën dhe foshnjat e saj duke i pastruar dhe ushqyer ato. Përveç kësaj, ato duhet t'i kryejnë të gjitha punët e tjera në koloni. Ato ndërtojnë korridore të reja në fole, kërkojnë ushqim dhe pastrojnë folenë. Milingonat punëtore dhe ushtarë, gjithashtu, ndahen në grupe të vogla ndërmjet tyre. Disa prej tyre janë mbarështues, disa ndërtues dhe disa kërkues të ushqimit. Çdo grup merret me nga një punë të ndryshme. Në kohën kur një grup lufton armiqet apo kërkon ushqim, grupi tjetër ndërton folenë, ndërsa një tjetër kujdeset për pastrimin dhe riparimin e folesë".


Kur mikësja e tij e vogël ia tregonte të gjitha këto, Omeri dëgjonte i mrekulluar, ndaj dhe e pyeti: "Nuk mërzhiteni asnjëherë duke pritur në hyrje të folesë gjatë gjithë kohës? Cila është detyra jote në fole?"

Milingona u përgjigj: "Unë jam punëtore dhe detyra ime është që të shërbej këtu si rojtare. Siç e sheh, koka ime është mjaft e madhe për ta mbuluar vrimën e hyrjes në fole. Jam e kënaqur që kam këtë aftësi dhe e kryej punën time me gëzim. Nuk mërzhitem kurrë, përkundrazi, jam shumë e kënaqur që i mbroj shoqet nga rreziqet".



**Punëtorët e
zellshëm në
punët e tyre.**



The background of the page is a soft-focus photograph of a pond. In the center, a white swan is swimming. In the bottom right corner, a dragonfly is visible. The water is calm, reflecting the surrounding greenery and sky. The overall atmosphere is peaceful and natural.

Omeri nuk kishte se si të mos habitej nga ato i tregoi milingona.

Milingonat punonin tërë kohën për t'ju ndihmuar të tjerëve, pa menduar fare për veten dhe pa asnjë problem - diçka që, madje, as njerëzit nuk mund ta arrijnë gjithmonë. Nga ato që i tregoi mikesha e tij e vogël, e kuptoi lehtë se, puna e folesë ishte e ndarë në mënyrë të përsosur ndërmjet milingonave. Ishte e qartë se, jeta e tyre kishte një rend të përsosur dhe të gjitha milingonat duhet të ishin shumë zemërgjëra.

Pastaj ai pyeti se, mos vallë kishte ndodhur ndonjë ngatërresë ndonjëherë, sepse disa prej tyre ishin më të mëdha dhe më të fuqishme se të tjerat. Mikesha e tij e siguroi se, asgjë e tillë nuk kishte ndodhur ndonjëherë dhe shtoi: "Ne jemi familje e madhe, Omer. Nuk ka zili, garë për t'u dukur apo ambicje ndërmjet nesh. Ne gjithmonë ndihmojmë njëra-tjetrën dhe mundohemi që t'i shërbejmë kolonisë sa më mirë. Gjithçka në koloni është e ndërtuar mbi sakrificë. Çdo milingonë, së pari, mendon për të mirën e shoqes së vet, pastaj për veten.

Më lejo të të jap një shembull. Kur nuk ka ushqim të mjaftueshëm në koloni, milingonat punëtore menjëherë kthehen në milingona "ushqyese" dhe ushqejnë të tjerat me ushqimin rezervë nga stomaku i tyre. Kur ka ushqim të mjaftueshëm në koloni, ato përsëri bëhen milingona punëtore.

I kam dëgjuar njerëzit duke thënë se, ka luftë për mbijetesë ndërmjet qenieve të gjalla në natyrë. Kurrë mos u beso atyre! Ne e dimë shumë mirë se, duhet të bashkëpunojmë që të jemi të suksesshëm."

Omeri i mrekulluar tha se, ato që dëgjoi nga milingona për veten dhe familjen e saj të madhe ishin një shembull i përsosur.

Ai u kënaq jashtë mase kur mësoi se, Zoti e kishte krijuar kaq zemërgjerë, kaq të dobishme dhe kaq të përkushtuar për shoqet e saj.

Pas asaj që dëgjoi, Omeri vendosi të bëhej i kujdesshëm dhe i matur me të tjerët, së paku aq sa milingonat dhe të bëhej një njeri, i cili fiton dashurinë e Allahut.

Ishte bërë shumë vonë dhe atij i duhej të niset për në shkollë. I tha mikeshës se duhet të shkonte, por, pa dyshim, do ta vizitonte edhe të nesërmen.



Të nesërmen, Omeri shkoi në të njëjtin vend dhe priti mikeshën e tij të vogël. Pas disa minutash, ajo erdhi. I tha se, kishte pritur tërë natën me padurim që ta takonte përsëri. Pastaj e përkujtoi për premtimin që i kishte dhënë për t'i treguar rreth brendësisë së folesë.

Kështu, milingona filloi t'i tregonte për shtëpinë e saj: "Ndonëse ne jemi insekte të imëta, foleja jonë është e stërmadhe, sikurse shtabi i përgjithshëm i një ushtrie gjigande. Nëse je i huaj, kurrë nuk do të mund të hysh brenda. Sepse, siç e di, në derë ka roje si unë. Brenda ka një aktivitet të pandërprerë dhe të mirëorganizuar. Me mijëra, madje, me miliona milingona ushtarë dhe punëtorë kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të rregullt. Fole të tona janë mjaft të përshtatshme për punë brenda tyre. Për çdo punë, ka dhomëza të veçanta dhe këto dhomëza janë ndërtuar në atë mënyrë që, milingonat ushtarë dhe punëtorë, si unë, ta kryejnë punën e tyre në mënyrën më të lehtë. Veç kësaj, ne i marrim parasysh të gjitha nevojat tona kur i ndërtojmë fole të. Për shembull, foleja jonë ka kate nëntokësore të cilat lejojnë vetëm një sasi të caktuar të rrezeve të diellit të futen brenda. Por, gjithashtu, ka disa dhomëza ku, energjia e diellit është shumë e nevojshme. Këto dhomëza i ndërtojmë në katet lart, ku mund t'i marrin rrezet e diellit në këndin më të gjerë të mundshëm.

Madje ka edhe dhomëza që duhet të jenë në komunikim të vazhdueshëm me dhomëzat e tjera.




Këto, ne i ndërtojmë pranë njëra-tjetrës, në mënyrë që milingonat mund ta takojnë më lehtë njëra-tjetrën.

Depoja për mbajtjen e ushqimit rezervë është e ndërtuar si ndarje e veçantë në një anë të folesë.

Hambaret ku ne mbajmë ushqimet tona, ndërtohen në vende ku mund të arrihen lehtë. Gjithashtu, në qendër të folesë kemi një sallë të madhe, ku mblidhemi në raste të caktuara."




Në foton anash shohim një qytet nëntokësor të ndërtuar nga milingonat. Pavarësisht se janë shumë të vogla, ato çuditërisht, mund të ndërtojnë qytete aq të mëdha mahnitëse



1. Sistemi i mbajtjes së temperaturës konstante. 2. Serrë. 3. Hyrja kryesore dhe hyrjet anësore. 4. Dhomëzat e gatshme. 5. Depoja e ushqimit. 6. Dhoma e rojtarëve. 7. Mbuaroja e jashtme. 8. Dhoma e infermiereve. 9. Depoja e mishit. 10. Depoja e drithit. 11. Dhoma e kujdesit për larvat. 12. Dhoma e dimërimit. 13. Reparti i ngrohjes qendrore. 14. Inkubatori. 15. Dhoma mbretërore...

Nuk ka dyshim që milingonat nuk mund t'i planifikojnë dhe shpikin të gjitha këto detaje. Ato janë të frymëzuara nga Zoti.



Kur Omeri i dëgjoji të gjitha këto për folenë, e pyeti mikeshën e tij të vogël: "Me të vërtetë, ju i bëni të gjitha këto?" Nuk e kam ditur që milingonat mund të punojnë si inxhinierë dhe arkitektë të shkolluar. Njerëzit duhet të kalojnë shumë vite në shkollë dhe të punojnë shumë për të ndërtuar ndërtesa aq të përsosura. Edhe ju ndiqni trajnime të tilla?

Si përgjigje, milingona vazhdoi me tregime marramendëse rreth shoqeve të saj:

"Jo Omer, ne këto dituri i kemi të lindura. Ato kurrë nuk na janë mësuar neve, por ne saktësisht e dimë se çfarë dhe kur duhet bërë.


Shtëpia që kanë ndërtuar milingonat është si kështjellë për to.



Prit, kjo nuk është e gjitha. Kjo që do të të tregoj tani do të të befasojë edhe më shumë. Siç të tregova, foleja jonë është shumë e madhe krahasuar me madhësinë tonë. Por, megjithatë, ajo ngrohet mirë. Në folenë tonë është një sistem shumë i përparuar i ngrohjes qendrore. Në këtë mënyrë, temperatura qëndron kudo njëlloj gjatë gjithë ditës. Për ta siguruar këtë, ne e mbulojmë sipërfaqen e jashtme të ndërtesës sonë me materiale të ndryshme, të cilat nuk e lejojnë nxehtësinë të depërtojë brenda. Në këtë mënyrë, ne e ndalojmë ajrin e ftohtë të hyjë brenda gjatë dimrit dhe të nxehtin gjatë verës. Ja se si e mbajmë temperaturën në të njëjtin nivel."

Nuk ka dyshim që Omeri, po mos ta kishte takuar këtë mikeshë të vogël, vështirë se do të besonte që milingonat mund t'i bëjnë këto gjëra. Ai i tha milingonës: "Sikur, para se të më tregojë ti, të më tregonte dikush për ndërtimin e folesë tuaj dhe të më pyeste se kush mund ta bëjë një gjë të tillë, do ta kisha të vështirë të përgjigjesha."





Do të thosha se një fole e tillë mund të ndërtohet vetëm me mjete shumë të sakta dhe me njerëz shumë të aftë dhe të stërvitur. Po të më thoshte dikush se kjo ndërtesë nuk është ndërtuar nga njerëz të shkolluar, por nga milingonat, të them të vërtetën, nuk do t'i besoja".

Kur mikesha e tij e vogël i tregonte të gjitha këto, shumë mendime ia përshkonin mendjen. Ai mendonte se ato janë mjeshtre më të mëdha se njerëzit dhe filloi të mendonte ndryshe për këto insekte. Ai e kuptoi se Zoti i kishte krijuar milingonat dhe se ishte frymëzimi i Zotit çdo çast që i bënte ato të silleshin në atë mënyrë.

Ndryshe, ato nuk do të ishin në gjendje t'i bënin të gjithë këto gjëra me sukses.



Mendimet vazhdonin të vërshonin në mendje, ndërsa, mikësja e tij vazhdonte të tregonte. Omeri sa vinte e më tepër bëhej kureshtar dhe donte ta pyesë për gjithçka që i binte ndërmend. Meqë kishte dëgjuar se milingonat sillen edhe si fermerë, e pyeti mikëshën e tij se si ato mund ta bëjnë këtë. Si mundet një milingonë, aq e vogël, ta punojë tokën pa asnjë mjet, diçka që edhe njeriu do ta bënte me vështirësi?

Milingona iu përgjigj: "Do të të tregoj edhe diçka tjetër për ne. Kështu do t'i përgjigjem lehtë pyetjes tënde. Edhe pse dukemi njëlloj, ne ndahemi në shumë grupe të dallueshme sipas mënyrës së jetesës dhe pamjes së jashtme.


Në Tokë ka rreth 8.800 lloje të ndryshme milingonash. Të gjitha këto milingona kanë tipare të veçanta. Milingonat fermere janë njëri prej këtyre llojeve. Tani do të tregoj për milingonat që merren me bujqësi. Ato quhen "attas", apo milingonat gjetheprerëse.



Tipari kryesor i tyre është bartja në kokë e copave të gjetheve që presin. Për këtë qëllim, ato së pari pastrojnë shtegun e tyre, që të lëvizin më lehtë nëpër të. Rruga e tyre për në fole, duke bartur gjethet e prera, ngjan me një autostradë të vogël. Milingonat ecin ngadalë nëpër këtë shteg, duke mbledhur të gjitha pengesat, copëzat e vogla të barishteve, zhavorrin dhe bimët e egra, dhe duke mënjanuar ato. Në këtë mënyrë ato e pastrojnë shtegun ku do të kalojnë.



Attasët presin gjethet me mjeshtëri dhe shumë kujdes.



Pas një pune të gjatë dhe të mundimshme, autostrada bëhet e drejtë dhe e lëmuar sikur të ishte rrafshuar me ndonjë mjet special. Atlas-ët ecin nëpër këtë shteg për të shkuar në fole, duke u fshehur nën copëzat e mëdha të gjetheve, të cilat i mbajnë me nofullat e tyre të shtrënguara fort."

OMERI: A mos the që fshihen nën gjethe? Pse atlas-ët e ndjejnë të nevojshme për t'u fshehur nën gjethe?

MILINGONA: Atlas-ët duhet të jenë të kujdesshëm ndonjëherë, Omer. Për shembull, punëtoret atlas me madhësi të mesme e kalojnë thujse gjithë ditën larg nga foleja, duke bartur gjethe. Për to, është e vështirë që të mbrohen, sepse gjethet i bartin me nofullat e tyre të cilat zakonisht përdoren për vetëmbrojtje.

OMERI: Po kur ato nuk kanë mundësi ta mbrojnë veten, kush i mbron ato?



1. Milingonat i copëtojnë gjethet e sjella në fole në grimca.
2. Këto grimca i përtypin duke i bërë masë.
3. Ato e vendosin këtë masë mbi gjethet e thara në dhomëza të reja.
4. Mbi këtë masë vendosin grimcat e kërpudhave të sjella nga dhomëzat e tjera.
5. Një grup i angazhuar milingonash pastron kopshtin duke hequr materialet e panevojshme.



MILINGONA :

Milingonat gjetheprerëse gjithmonë shoqërohen nga punëtore më të vogla. Këto punëtore ngjiten në majë të gjetheve që mbajnë attas-ët dhe i bëjnë sytë katër. Në rast të ndonjë sulmi nga armiqtë, ata mbrojnë shokët e tyre, pavarësisht se janë aq të vegjël.



OMERI: Ky është edhe një shembull tjetër mahnitës i vetësakrifikimit. Po unë dua të di edhe një gjë. Përse i përdorin attas-ët këto gjethe? Pse attas-ët i bartin këto gjethe gjatë gjithë ditës?

MILINGONA: Ata i përdorin ato për bujqësinë e tyre. Attas-ët i përdorin këto gjethe për të kultivuar kërpudha. Milingonat nuk mund t'i hanë gjethet.

Kështu që milingonat punëtore, pasi i përtypin këto gjethe, bëjnë një grumbull dhe i fusin nën tokë në dhomëzat e folesë së tyre. Në këto dhomëza ato i

kultivojnë kërpudhat në gjethe dhe e sigurojnë ushqimin e tyre nga filizat e kërpudhave.

Tani me siguri do të pyesësh se, si milingonat e vogla mund të bëjnë caq gjëra të mrekullueshme?

OMERI: Po. Me të vërtetë po përpiqem ta kuptoj se si milingonat arrijnë t'i bëjnë të gjitha këto. Për shembull, nëse më thua të kultivoj kërpudha, do të ishte shumë vështirë për mua. Së paku duhej të lexoja disa libra dhe të kërkoja ndihmë prej njerëzve që e dinë këtë punë. Por e di që attas-ët nuk trajnohen nga dikush. Tani po e kuptoj më mirë çfarë ju bën juve dhe shoqet tuaja milingona aq të talentuar. Ju jeni të programuara ta bëni punën tuaj.



Për shembull attas-ët vijnë në botë duke ditur për bujqësinë. Pa dyshim, Zoti, Krijuesi i gjithë gjallesave, ua dha attas-ëve këtë dituri. Zoti është Ai i Cili të krijoj ty dhe të gjithë shoqet e tua me gjithë këto tipare mahnitëse.



MILINGONA: Ke të drejtë Omer. Ne i dimë këto gjëra sepse me to kemi lindur. Zoti, Krijuesi ynë, na i dha këto si bekim.

Omeri përsëri u vonua. Pasi e falënderoi miken, u nis për në shkollë. Duke ecur, i jehonin në veshë ato që i tregoi milingona. Ndërkaq, ai vazhdonte të mendonte. Veprat mjeshtërore të milingonave, tregonin për një urtësi të madhe. Por, kjo urtësi nuk mund t'u takonte vetë milingonave. Ato në fund të fundit ishin krijesa të imëta. Atëherë, të gjitha aftësitë e milingonave duhet t'u tregojnë njerëzve mençurinë e Zotit. Për të treguar madhështinë e ekzistencës së Tij dhe artin e krijimit, Zoti, Krijuesi i milingonave, i bëri këto krijesa të imëta të kryejnë gjëra që kurrë nuk do të mund t'i bënin me mençurinë dhe dëshirën e tyre. Mikesha e tij, urtësinë e lindur që kishte, aftësinë dhe natyrën e sakrifikimit, ia detyronte frymëzimit të Zotit. Çdo gjë që bënte, ishte argument jo i saj, por i fuqisë dhe mençurisë së Zotit.

Duke menduar për këtë, ai e kuptoi se disa gjëra që i imagjinonte ndryshe, tani u zëvendësuan me fakte të vërteta. Ai, edhe një herë, e kuptoi se tregimet për gjallesat, se si ato erdhën në jetë rastësisht, se si i fituan aftësitë e tyre rastësisht me kalimin e kohës, ishin gënjeshtër. Si mund të jenë të vërteta? Vetëm mendo, si mund të "flasim" milingonat njëra me tjetrën aq mirë po të kishin ardhur në botë rastësisht? Si do të mund të komunikonin njëra me tjetrën pa kurrfarë çrregullimi dhe të ndërtonin fole aq të përsosura? Përveç kësaj, edhe sikur të gjitha këto milingona të kishin ardhur në ekzistencë rastësisht dhe sikur të jetonin vetëm për ta mbrojtur veten, atëherë si mund të ndodhë që ato të bëjnë aq sakrifica të mëdha për njëra-tjetrën? Ai mendonte për këto gjëra gjatë gjithë ditës në shkollë.



Attasët duke mbartur gjethet që kanë prerë

Kur shkoi mbasdite në shtëpi, vendosi ta lexonte Kur'anin, të cilin Zoti ua zbriti të gjithë njerëzve. Vargu i parë që lexoi ishte ky:

"Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. Për ata që All-llahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): "Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!" (Ali Imran: 190-191).

Ai ishte plotësisht i bindur që vetë Zoti krijoi milingonat, atë, nënën dhe babanë e tij, vëllain e tij dhe gjithçka në univers. Mikesha e tij e përkujtoi për gjënë më me rëndësi në botë. Ajo ishte: "Nuk ka krijues tjetër pos Zotit".



Besoj se kur t'i lexoni këto rreshta, të gjithë ju do ta kuptoni të vërtetën, sikurse

Omeri, dhe do ta mësoni se Zoti është Ai, i Cili krijoi gjithçka.

Pastaj do të thoni: "Darvini, i cili tha se qeniet e gjalla nuk u krijuan, por erdhën në jetë rastësisht, ishte një gënjeshtar i madh. Kur jemi të rrethuar me krijesa me aq aftësi mahnitëse, është e pamundur të mendojmë që ato erdhën në jetë rastësisht".

Prandaj, nëse edhe ju takoheni me ndonjë mik të mirë sikurse Omeri, mos harroni se keni shumëçka të mësoni prej tij. Studioni dhe mendoni për përsosmërinë e artit të Zotit, i Cili e krijoi atë. Dhe nëse ndonjëherë takoni gënjeshtarë si Darvini, tregojuni atyre për tiparet e miqve tuaj të vegjël dhe u thoni se kurrë nuk do t'u besoni gënjeshtrove të tyre të pakuptimta.



**Ëngjëjt thanë: “Lavdia të qoftë Ty Zoti
ynë. Ne nuk kemi dije tjetër përveç
asaj që na dhurove. Ti je i
Gjithëdijshmi, i Urti.”
(Sure Bekare: 32)**





Gjithashtu nga Harun Jahja

